

Auleda

AULEDA është një organizatë jofitimprurese e krijuar në Gusht 2003, për të shërbyer 300,000 banorëve të Qarkut Vlorë me një sipërfaqe prej 2706 km² me zyrën qendrore në qytetin e Vlores.

Qarku Vlorë përfshin 4 Bashki dhe 19 komuna: Vlorë, Oriku, Sarandë, Delvinë, Qender, Novosele, Shushicë, Armen, Vllahinë, Sevastër, Kote, Barataj, Hore-Varnisht, Finiq, Mesopotam, Vergo, Lukovë, Livadhje, Markat, Xare, Dhiver, Ksamil, Aliko. AULEDA është formuar nga aktorë privat dhe publik, të cilët janë dakord për strategjitë dhe iniciativat me qëllim nxitjen dhe eksplorimin e burimeve lokale, duke kontribuar në një zhvillim ekonomik të qendrueshëm. Organizata siguron asistencë institucionale lokale, publike dhe komunave si dhe qeverive lokale. AULEDA synon të rrisë kushtet ekonomike dhe sociale në rajonin e Vlores; duke promovuar mobilizim në shfrytëzimin e risurseve lokale dhe zhvillim të shoqërisë civile. AULEDA realizon përgatitje dhe implementim projektesh, duke nxjerrë në pah studime sektoriale të caktuar, suport kapacitetesh në ndërtim aktivitetesh institucionale dhe organizim takimesh apo evenimentesh mobilizim opinionesh dhe qëndrim inovativ në një zhvillim ekonomik të qendrueshëm.

Me këtë synim, objektivat kryesore të AULEDA-s janë identifikimi, analiza dhe zbatimi i nismave favorizuese për aktivitete të zhvillimit ekonomik dhe për krijimin e mundësive për punësim. AULEDA ndërmerret përgatitjen e projekteve dhe zbatimin e tyre, kryen studime sektoriale, mbështet aktivitete të rritjes së kapaciteteve të administratës publike dhe organizon aktivitete të shumëllojshme që mobilizojnë opinionin publik dhe e informojnë për arritje të zhvillimit ekonomik lokal.

DREJTIMET KRYESORE

- Pjesëmarrje në Projekte Zhvillimesh.
- Konsulencë dhe asistencë teknike për krijimin e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme, në fillimet apo dhe gjatë punës së tyre, kreditim i vecant për mundësi investimi.
- Kapacitete institucionale dhe organizative si dhe inisjativa në implementim Strategjisë të Zhvillimit Ekonomik Lokal.

FUSHAT E PRIORITETEVE

- Zhvillim i Qendrueshëm i Turizmit
- Agro ushqimor.
- Peshkim
- Artizanat

MOTOJA JONË

- Një vision i përbashkët i të ardhmes.
- Që të ecësh përpara, zgjidh rrugën e duhur.